

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07

Prokurori kundër Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtruesi: Mbrojtësi i Specializuar i Hysni Gucatit

Data: 15 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Konfidenciale

Kërkesë për shtyrjen e orës së caktuar për seancën e paraqitjes së parë

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit për Hysni Gucatin

Xhonatan Elistan Ris QC

Hju Bouden

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Bastian Martens

KËRKESË

1. Më 14 dhjetor 2020 ZSP-ja parashtrori Aktakuzën e konfirmuar,¹ me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.²
2. Në përputhje me rregullat 87(6) dhe 92 (1) Gjykatësi i Vetëm vendosi të mbajë seancën e paraqitjes së parë të z. Gucatit të premten, më 18 dhjetor 2020, në orën 11:00.
3. Kur caktoi këtë datë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mori parasysh mundësitë për të udhëtuar të të gjithë mbrojtësve, në rrethana të pandemisë aktuale të KOVID-19.
4. Mbrojtësi i specializuar, z. Xhonatan Elistan Ris QC, dhe Bashkëmbrojtësi i specializuar, z. Hju Bouden, kërkojnë që seanca të shtyhet për në orën 14:00, në mënyrë që të shkurtohet koha e udhëtimit dhe koha në transit.
5. Mbrojtësi i Specializuar i z. Haradinajt, z. Bastian Martens, ka bërë të ditur se seanca e paraqitjes së parë të z. Haradinaj, e caktuar për të premten, 18 dhjetor 2020, në orën 14.00, mund të mbahet më herët, përkatësisht në orën 11.00, për mundësimin e kësaj kërkesë.
6. Gjithashtu, kërkohet që z. Gucati të sillet në gjykatë për seancën, dhe që Mbrojtësit dhe Bashkëmbrojtësit t'u mundësohet të takohen me z. Gucati në mjediset e Dhomave të Specializuara për më së paku 2 orë përpara fillimit të seancës.

¹ KSC-BC-2020-07, F00075, Prokurori i Specializuar, Parashtrim i Aktakuzës së konfirmuar, 14 dhjetor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale ("Aktakuza e konfirmuar"), dhe shtojcën 2, publike ("Aktakuza e konfirmuar e redaktuar publike").

² Vendimi i konfirmimit, para. 155(c).

Numri i fjalëve (në origjinal) – 217 fjalë

/nëshkrimi/

Xhonatan Elistan Ris QC

Mbrojtës i specializuar për Hysni Gucatin

Hju Bouden

Bashkëmbrojtës i specializuar për Hysni Gucatin

15 dhjetor 2020

Kardif, Mbretëria e Bashkuar